



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 16 janar 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Petar Miletqi.

Mungoi: Shaip Muja.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Ramadanaj- KDI/TIK

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja mbajtur më 19 dhjetor 2012;
3. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Hartimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2013;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 19 dhjetor 2012;

3. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2012

Albin Kurti - Tha se të gjithë anëtarëve të Komisionit u është shpërndarë nga një draft-raport vjetor rreth aktiviteteve të Komisionit, gjatë vitit 2012.

Në draft-raport propozoi që në fjalinë, tek ftesa për ministrin Enver Hoxhaj, të plotësohet edhe me ftesën që i është bërë ministrit në muajin dhjetor, për të raportuar lidhur me çështjet e buxhetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2013, në të cilën po ashtu, nuk është përgjigjur.

Në nëntitullin, vizitat jashtë vendit, ai propozoi që të riformulohet fjalia.

Sabri Hamiti - Propozoi që nëntitulli i draft-raportit të punës së Komisionit për vitin 2013, “Vizitat jashtë vendit”, të zëvendësohet me nëntitullin “Komunikimi me jashtë”. Duke shtuar se anëtarët e Komisionit kanë pasur vizita pune jashtë vendit, gjatë vitit të kaluar, propozoi që secili anëtarë i Komisionit të ofrojë të dhënat mbi vizitat e realizuara, dhe ato të jenë pjesë e Raportit të punës së Komisionit për vitin 2013.

Hydajet Hyseni- Theksoi se nëse kemi kohë për miratim të Raportit vjetor, do të ishte mirë që së pari, ai të shqyrtohet, të plotësohet e pastaj të miratohet. Hyseni propozoi që Raporti të plotësohet edhe për pjesëmarrjen e kryetarit të Komisionit, në takimet me kryetarët e të gjitha komisioneve parlamentare dhe të shikohet se a ka mbetur ndonjë aktivitet i Komisionit i pa përfshirë.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2012, me plotësimet e ndryshimet e anëtarëve të Komisionit.

4. Hartimi i Planit dhe i Programit të punës së Komisionit për vitin 2013

Sabri Hamiti - Duke u ndërlidhur me Planin dhe Programin e punës së Komisionit për vitin 2013, informoi anëtarët e Komisionit, se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, është miratuar kërkesa e Komisionit, për lejimin e organizimit dhe financimin e tryezës rajonale. Kryesia e Kuvendit ka vendosur ta financojë qëndrimin e pjesëmarrësve, duke e shtruar çështjen e racionalizimit të numrit të të ftuarve. Shpenzimet e udhëtimit të pjesëmarrësve, si zakonisht barten nga vetë pjesëmarrësit.

Albin Kurti - Falënderoi deputetin Sabri Hamiti, për informimin lidhur me tryezën rajonale, për të cilën tha, se është çështje shumë e rëndësishme e punës së Komisionit, për të cilën kanë shprehur interesim të na ndihmojë edhe zyra e z. Samuel Zhbogar, përfaqësuesit special të BE-së në Kosovë. Si çështje parimore me të cilat do të duhej të merrej Komisioni gjatë vitit 2013, tha se është insistimi i Komisionit në mbikëqyrjen e punës së ministrisë, duke pasur parasysh edhe rekomandimet nga interpelanca e datës 11 tetor 2012, si dhe rekomandimet e Komisionit pas miratimit të Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës. Lidhur me punimin e ekspertit Blerim Dervishi, për diplomacinë parlamentare, shtroi nevojën e një bashkëpunimi të Komisionit me Komisionin për Integritet Evropian dhe me Kryesinë e Kuvendit, për shqyrtimin e atij dokumenti, se a do të mund të shfrytëzohet më tepër se sa një informatë.

Skender Hyseni - Parashtroi detyrën e Komisionit, në veçanti dhe të Kuvendit në përgjithësi që ta ushtrojë një kontroll demokratik, më të përafërt mbi punën e MPJ-së.

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme, tha se është duke u bërë një degradim total profesional e politik, me punësimin e militantëve partiakë dhe pa asnjë kriter. Duke cekur gjendjen e vështirë në MPJ, për shkak të emërimeve në baza partiake, pa respektim të procedurave dhe konkursit, shkeljet e të drejtave të 600 aplikuesve gjatë vitit të kaluar dhe ngecjeve të tjera, kërkoi që ministri Enver Hoxhaj, të ftohet për të raportuar në Komision.

Hydajet Hyseni - Lidhur me planin e programin e punës së Komisionit, tha se duhet të plotësohet konform ligjit dhe fushëveprimtarisë së Komisionit. Përkrahë idenë që në Planin dhe në programin e punës të përfshihet edhe nisma legjislative dhe aktivitetet e jashtme të Komisionit. Pas përfshirjes së çështjeve në Planin dhe në Programin e punës, tha se duhet të hartohet një strategji për angazhimin dhe realizimin e obligimeve tona.

Enis Kervan - Lidhur me draft- planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2013, theksoi se ka ngjashmëri me atë të vitit 2012, dhe kërkoi që të ndryshohet. Propozoi që në Planin e programin e punës së Komisionit për vitin 2013, të parashihet që të ftohen për raportim edhe zëvendëskryeministrat, ngase lidhur me njohjet, ata dalin me deklarime të ndryshme. Përkrahu propozimin që ministri Enver Hoxhaj, të ftohet për të raportuar në Komision.

Sabri Hamiti - Theksoi se ministri e ka për detyrë që t'i përgjigjet ftesës së Komisionit, dhe kjo është çështje me program të Komisionit. Përkrahu propozimin që të ftohet ministri Hoxhaj për të diskutuar mbi realizimin e rekomandimeve nga mocioni në Kuvend, gjendjen e politikës së jashtme, problemet brenda emërimeve në Ministri dhe e rekomandimeve nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjit.

Donika Kadaj-Bujupi - Theksoi se është i domosdoshëm një presion publik më i madh, në formë të organizuar prej Komisionit në raport me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ka ankesa të mëdha nga njerëzit që punojnë në MPJ, për mënyrën e funksionimit të Ministrisë.

Emilja Rexhepi - Tha, se ne duhet ta rrisim dinamikën në përmbushjen e obligimeve tona karshi qytetarëve tanë. Ne mund ta ftojmë ministrin që të raportojë sa herë që Komisioni këtë e shihet nevojshme, por edhe ministri në rast të pamundësisë që të vijë, mund ta caktojë dikë që të raportojë në Komision.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P e r f u n d i m

Të përgatitet ftesa dhe të ftohet ministri i MPJ, z. Enver Hoxhaj që të raportojë në Komision, lidhur me:

- *përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit, të nxjerra pas interpelancës të datës 11.10 2012,*
- *përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit për Punë të Jashtme, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 03/L-122, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të dt. 13 dhjetor 2012 si dhe*
- *buxhetin e MPJ, për vitin 2013.*

5. Të ndryshme

Albin Kurti - I njoftoi anëtarët e Komisionit, që një grup studentësh nga Shoqata e studentëve të shkencave politike të Universitetit të Leiden-it të Holandës, do të ketë një vizitë studimore në Kosovë, dhe ata kanë kërkuar që të takohen me Komisionin tonë. Takimi me këta studentë do të mbahet të premtën, më 25 janar, në orën 14:15.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti